

**RREGULLORE
PER
GJYKIMIN DISIPLINOR PROFESIONAL**

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes, të hetimit dhe gjyimit të proceseve disiplinore profesionale , si dhe të ekzekutimit të tyre. Këto rregulla janë të detyrueshme për çdo individ të procedimit disiplinor, që ushtron profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë.

Mbështetur nga këto akte normative, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë(UFSH) nëpërmjet organeve të gjyimit disiplinor profesional, heton dhe gjykon në mbështetje të fakteve dhe provave të gjitha rastet e shkeljes së Kodit të Deontologjisë Farmaceutike si dhe gabimet teknike të farmacistëve gjatë ushtrimit të profesionit në rastet e ;

1. Mosrespektimit të standardeve, parimeve dhe normave të etikës e të moralit profesional gjatë ushtrimit të profesionit, të tilla si :
 - komunikim i papërshtatshëm dhe pritje jo korrekte e pacientëve;
 - qëndrime diskriminuese të karakterit etnik, racor, fetar, partiak-politik si dhe ndaj shtresave a klasave shoqërore;
 - shfrytëzim i pozitës profesionale ndaj pacientit ose të tretëve për përfitime nga ai në formë mitmarrjeje, mitdhënieje apo forma të tjera përfitimi;
 - pakënaqesi si rrjedhojë e komunikimit jo korrekt, siç është sqarimi i pamjaftueshëm mbi përdorimin e barnave dhe shpjegime të tjera, që i kërkon pacienti;
 - sjellje jo korrekte me kolegët, cënim të të drejtave ligjore dhe imazhit të tyre;
 - mosorganizim i farmacisë sipas praktikës së mirë të farmacisë;

- mosrespektim i ligjshmërisë për reklamimin e barnave dhe farmacisë
- lidhje mjek farmacist për qëllime përfitimi materiale;
- etj

2. Veprimtarisë profesionale të ulët, me pasojë rrezikimin e shëndetit dhe jetës së pacientëve si :

- ushtrimi i profesionit nga persona jo farmacistë është përgjegjësi e drejtuesit teknik ose e farmacistit të punësuar në rastet kur mungon drejtuesi teknik dhe kur, sa më sipër, kryhet pa dijeninë e tij;
- dhënia e barnave të pa regjistruara në Shqipëri si pasiguri ndaj barit dhe shëndetit të të sëmurit;
- gabime të përsëritura farmaceutike me pasoja rrezikimin apo dëmtimin e shëndetit të të sëmurit, humbje të jetës (vdekje nga gabimi farmaceutik);
- trajtim të pacientëve tej kufijve të kompetencës profesionale;
- mungesë gadishmërie dhe paaftësi për të ndihmuar të sëmurin;

3.Papërgjegjshmërisë në marrjen e vendimit për mjekim të të sëmurit pa kaluar tek mjeku, duke vënë në rrezik shëndetin dhe jetën e të sëmurëve.

4.Shkeljes së Ligjit Nr nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH”, Statutit dhe Kodit Deontologjik Farmaceutik, akteve të tjera normative të UFSH dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi.

5.Papërgjegjshmërisë ose sjelljes jo etike apo jo korrekte në ushtrimin e detyrës funksionale

Neni 2

Qëllimi

Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional ka për qëllim të sigurojë një gjykim të drejtë, të paanshëm e të rregullt disiplinor, të ruajë dhe garantojë ushtrimin e profesionit të farmacistit sipas kërkesave shkencore, të normave të moralit dhe të etikës mjekësore, të mbrojë të

drejtat e interesat e ligjshme të pacientëve dhe konsumatorëve nga kequshtrimet e profesionit, si dhe të ndihmojë për një zbatim efikas dhe të drejtë të Ligjit Nr nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH”, Statutit dhe Kodit Deontologjik Farmaceutik, dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Gjykimi Disiplinor Profesional vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, objektivitetit, paanësisë, transparencës, përgjegjësisë dhe korrektësisë së zbatimit të legjislacionit në fuqi.
2. Të gjitha ankesat e mbërritura pranë Urdhrit të Farmacistëve, si në qendër ashtu dhe në rajone, pa përjashtim, i nënshtrohen shqyrtimit në Këshillin Rajonal.
3. I nënshtrohen veprimit disiplinor :
 - a. Ankesat me shkrim dhe të nënshkruara nga ankuesi apo institucioni zyrtar, që bën ankimin kur gjykohet se janë objekt gjykimi disiplinor .
 - b. Aktet e Mbikëqyrjes Profesionale të mbajtura nga Inspektorët e Urdhrit gjatë ushtrimit të mbikëqyrjeve, kur gjykohet se janë objekt gjykimi disiplinor .
 - c. Konstatimet e sinjalizuara nga mas-media etj, kur gjykohet se janë objekt gjykimi disiplinor.
4. Gjykimet në Komisionin Disiplinor të Gjykimit Profesional(KDGJP) në seancën dëgjimore i nënshtrohen edhe rastet për të cilat vendos Këshilli Rajonal, ose që, për specifikë të veçantë, shqyrtohen nga Këshilli Kombëtar dhe dërgohen prej tij.
5. Palët në gjykim kanë të drejtë të asistohen për mbrojtje nga një person, të cilin e caktojnë vetë.
 6. KDGJP i shkallës së parë, apo të dytë kur e cilëson të domosdoshme prezencën e palëve në seancë dëgjimore, atëherë ata janë të detyruar të jenë prezent.
7. Kur çështja e ankimuar i është referuar organeve të drejtësisë, UFSH kryen të gjitha veprimet konform kësaj rregulloreje duke krijuar të plotë Dosjen e Çështjes. Nga ky moment, pezullohet Veprimi Disiplinor, për të vazhduar më tej, pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga keto organe. Nëse çështja e ankimuar është objekt i gjyimit nga organet e drejtësisë vetëm për një pjesë të saj ose kur Komisioni gjykon se ka argumenta të mjaftueshme për të gjykuar çështjen për shkelje të Statutit dhe Kodit Deontologjik, dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi, të cilat nuk janë argument i çështjes së ndjekur nga organet e drejtësisë, komisioni ndjek te gjitha procedurat e parashikuara për gjykimin

disiplinor deri në marrje të një vendimi përfundimtar. Çështja rimerret në shqyrtim pas marrjes së vendimit të formës së prerë nga organet e drejtësisë dhe gjykohet për pjesën e mbetur.

Pjesa e parë

KOMISIONET DISIPLINORE FUNKSIONET DHE PERBERJA E TYRE

Neni 4 Funksionet e KDGJP

- 1.KDGJP është organi i vetëm që jep masën disiplinore.
- 2.Askush nuk mund të ndëshkohet profesionalisht pa vendim të KDGJP.

Neni 5 Pavarësia e Komisioneve të Gjykimit Disiplinor Profesional

1. KDGJP janë të pavarura dhe vendosin në bazë të ligjit nr.9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH”, Statutit dhe Kodit Deontologjik Farmaceutik si dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi.
- 2.KDGJP japin vendime në bazë të provave, që shqyrtohen e verifikohen në seancë dëgjimore.

Neni 6 Nivelet e Gjykimit Disiplinor Profesional

Gjykimi profesional kryhet në dy nivele(shkallë):

- 1.Shkalla e parë, e cila organizohet e kryhet pranë Këshillit Rajonal dhe zhvillohet në dy faza:

A.Hapja e Dosjes, njohja paraprake me të dhënat, caktimi i relatuesit-verifikues si dhe i ekipeve ndihmëse (kur gjykohen të nevojshme), realizohen nga Kryesia e Këshillit Rajonal.

B.Gjykimi në seancë dëgjimore nga Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional dhe marrja e vendimit.

Komisioni Disiplinor për shkallën e parë të gjykimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, 2 (dy) farmacistë dhe 1 (nje) jurist.

2.Shkalla e dytë (Apeli) që organizohet dhe kryhet pranë Këshillit Kombëtar.

Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, 6 (gjashtë) farmacistë dhe 1 (nje) jurist.

Neni 7

Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional të shkallës së parë dhe përbërja e tyre

- 1.Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional ngrihet pranë Këshillit Rajonal dhe është në funksion vetëm të këtij Këshilli.
2. Komisioni Disiplinor, për shkallën e parë të gjykimit (KD 1), i ngritur pranë KR ka në përbërjen e tij 5 anëtarë nga të cilët 3(tre) janë farmacistë dhe 2(dy) juristë përveç KDGJP pranë KR/Tiranë që ka në përbërjen e tij 7(shtatë) anëtarë nga të cilët 5(pesë) janë farmacistë dhe 2(dy) juristë. Për çdo çështje në gjykim vetëm 3 (tre) nga këta, 2 (dy) farmacistë dhe 1 (një) jurist caktohen në përberje të Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional.
3. Kryetari dhe sekretari i KDGJP për shkallën e parë të gjykimit zgjidhet nga anëtarët e këtij komisioni.

Neni 8

Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional i shkallës së dytë dhe përbërja e tij

1. Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional i shkallës së dytë (KD 2) ngrihet pranë Këshillit Kombëtar të UFSH-së dhe është në funksion të këtij këshilli.
2. Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional përbëhet nga 15 anëtarë farmacistë dhe 2 juristë. Për çdo çështje në gjykim të shkallës së dytë, vetëm 7 (shtatë) nga anëtarët e këtij komisioni, 6 (gjashtë) farmacistë dhe 1 (nje) jurist, caktohen në përberjen e Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional.
3. Kryetari dhe sekretari i KDGJP për shkallën e dytë të gjykimit zgjidhet nga anëtarët e këtij komisioni.

Neni 9

Përzgjedhja dhe Emërimi

1. Anëtarët e Komisioneve Disiplinore për të dy shkallët e gjykimit përzgjidhen dhe emërohen në këtë mënyrë:

a) Kandidatët për anëtarë të KD1 dhe KD2 mund të propozohen nga Kryesia e Këshillit Rajonal, e Këshillit Kombëtar apo nga çdo farmacist, anëtar i UFSH. Propozimet paraqiten pranë KR për anëtarët e KD1 dhe pranë KK për anëtarët e KD2, brenda 5 ditëve pune nga shpallja e mbledhjes së Asamblesë Rajonale dhe asaj Kombëtare respektivisht. Lista e kandidatëve u bëhet e ditur të gjithë anëtarëve të UFSH, të cilët mund të kontestojnë kandidaturat e paraqitura. Kur nuk ka argumente të mjaftueshme për të rrëzuar paraprakisht kandidaturën e kontestuar, KR ose KK, respektivisht kur bëhet fjalë për kandidature për KD1 ose KD2, paraqet kontestimet përkatëse në mbledhjen e Asamblesë Rajonale ose atë të Përgjithshme.

b) Anëtarët e KD1 caktohen nga Asambleja Rajonale me shumicë votash.

c) Anëtarët e KD2 caktohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash.

2. Anëtarët juristë për çështjet në gjykim në KD1 dhe KD2 duhet të kenë eksperiencë pune mbi 3 vjet dhe preferohet të kenë njohuri mbi legjislacionin farmaceutik.

3. Kandidatët farmacistë për anëtarë të Komisioneve Disiplinore të dy shkallëve, nëse nuk kandidojnë në mënyrë vullnetare u merret miratimi përpara se të propozohen.

Neni 10

Kriteret e përzgjedhjes

Kandidaturat për anëtarë të Komisionit Disiplinor të Gjykimit Profesional për të dy shkallët e gjykimit përzgjidhen duke u orientuar nga këto kritere:

1. Përvojë jo më pak se 10 vjet në ushtrimin e profesionit të farmacistit.
2. Prestigj dhe reputacion etiko-deontologjik e profesional ndër kolegë .
3. Mundësisht përvojë për veprimtari administrative .
4. Ndalohen kategorikisht të zgjidhen në Komisionet Disiplinore ata persona, që janë ndëshkuar për shkelje të ndryshme në ushtrimin e profesionit .
5. Ndalohet kategorikisht që në Komisionet Disiplinore të zgjidhen persona, që janë në funksione drejtuese shtetërore ose drejtues të institucioneve shëndetësore.
6. Pozicioni i anëtarit të KDGJP për shkallën e parë është i papajtueshëm me atë të anëtarit të KDGJP të shkallës së dytë dhe anasjelltas.

Neni 11

Kohëzgjatja e Mandatit në Komisionet Disiplinore të Gjykimit Profesional

Mandati i anëtarit të Komisioneve Disiplinore për të dyja shkallët e Gjykimit është 4 (kater) vjet, me të drejtën e rizgjedhjes.

Neni 12

Ngritja e Komisioneve Disiplinore

Përbërja e Komisionit Disiplinor, si dhe Kryetari i Komisionit caktohet :

- a) Për shkallën e parë nga Kryesia e Këshillit Rajonal përkatës.
- b) Për shkallën e dytë (e Apelit) nga Bordi Drejtues i Aparatit Qendror Ekzekutiv.

Ngritja e Komisioneve për shkallën e parë të gjykimit urdhërohet nga Presidenti i Këshillit Rajonal dhe në mungesë të tij nga Zëvendesi, ndërsa për shkallën e dytë thirrja e Komisionit urdhërohet nga Presidenti i Këshillit Kombëtar, nga Zëvendesi në mungesë të tij ose në raste të veçanta nga një person i autorizuar nga Presidenti i UFSH-së.

Neni 13

Lirimi i parakohshëm nga detyra në Komisionin disiplinor të Gjykimit Profesional

Lirimi i parakohshëm nga detyra e anëtarit të Komisionit bëhet kur :

- a) Kërkon vetë dorheqjen;
- b) Dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale ose shkelje administrativo-disiplinore ;
- c) Shpërdoron detyrën në Komision ose i shmanget gjykimit objektiv;
- d) Nuk zbaton legjislacionin në fuqi, Kodin Deontologjik dhe Statutin, Rregulloren dhe aktet e tjera normative të UFSH.
- e) Mungon tri herë, pa shkaqe të arsyetuara, në seancat e gjykimit profesional .
- f) Paaftësohet ose invalidizohet për arsye shëndetësore.

Propozimin për largimin e parakohshëm kanë të drejtë t'ia paraqesin Këshillit Kombëtar me shkrim:

- Këshilli Rajonal, që e ka kandiduar ose Presidenti i tij .
- Bordi Drejtues i Aparatit Qëndror Ekzekutiv apo Presidenti i UFSH.
- Anëtarë të UFSH

Për anëtarët e Komisionit Disiplinor të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë (apeli) largimi bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 14 **Burimet e Ankesave**

Ankesat ndaj farmacistëve mund të vijnë nga:

- a) Pacientë, familjarë të tyre, të afërm dhe qytetarë të tjerë.
- b) Çdo anëtar i Urdhrit të farmacistëve.
- c) Çdo institucion publik, ent publik ose jo publik.

Ankesa e mbërritur pranohet nga Këshilli Rajonal, të cilit i përket farmacisti i paditur dhe shqyrtohet në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore.

Neni 15 **Papajtueshmëritë e funksionit të anëtarit të KDGJP**

1. Funkzioni i anëtarit të KDGJP është i papajtueshëm me funksionin e Presidentit të Këshillit Rajonal si dhe të Presidentit, Zv/Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Urdhrit të Farmacistëve.
2. Ndalohet pjesëmarrja në Komisionet Disiplinore, si dhe në ekipet ndihmëse për një çështje të caktuar e personave, që kanë lidhje gjinie, farefisi apo çfarëdo lidhje tjetër shoqërore apo miqësore me personat në gjykim, ose që kanë një konflikt interesi me çështjen në gjykim.
3. Mosdeklarimi i tyre sjell pezullimin e gjykimit dhe anulimin e vendimit kur gjykimi ka përfunduar. Ndaj personit mbahet qëndrim dhe i bëhen në ngarkim shpenzimet e gjykimit.

Neni 16

Veprimi Disiplinor për anëtarët e UFSH me shtetësi të huaj

Farmacistët shtetas të huaj, anëtarë të UFSH, u nënshtrohen të gjitha procedurave të gjykimit sikurse shtetasit shqiptarë. Për vendimet e marra njoftohet organi homolog i vendit të tyre. (Urdhri/Shoqata, etj)

Pjesa e dytë

PROÇESET E GJYKIMIT DISIPLINOR

Neni 17

Kompetencat vendimmarrëse të Kryesisë së Këshillit Rajonal dhe Komisioneve Disiplinore

Dosjen e Çështjes në Këshillin Rajonal e përgatit dhe e administron Kryesia e Këshillit Rajonal, e cila ia kalon për shqyrtim dhe gjykim KDGJP të shkallës së parë.

1. Komisioni Disiplinor i Gjykimit Profesional të shkallës së parë, heton dhe gjykon, në bazë të fakteve dhe dokumentacionit të paraqitur, verifikimeve të kryera si dhe fakteve provave të administruara në seancë dëgjimore.

Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë" si dhe Kodit Deontologjik, KDGJP vendos për;

- a. Vërejtje me shkrim;
- b. Vërejtje me paralajmërim;
- c. Gjobë nga 10.000 (dhjetëmijë) deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë .

- d. Shkarkim nga organet drejtuese të Urdhrit të Farmacistëve dhe heqje të së drejtës për t'u rizgjedhur në këto organe.
 - e. Përrjashtim nga anëtarësia në Urdhër deri në 3 (tre) vjet, çka nënkupton heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit për këtë periudhë.
2. Komisioni Disiplinor ka të drejtë t'u caktojë kundërvajtësve, si masë plotësuese, kryerjen e një rikualifikimi në institucionet publike, sipas tarifave të caktuara.

3. Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë (i Apelit) ka këto kompetenca:

a) Lë në fuqi Vendimin e KDGJP të shkallës së parë ose e ndryshon atë sipas gjykimit të tij.

b) Rikthen çështjen për rigjykim në KDGJP të shkallës së parë, në rastin kur gjykohet se ka fakte dhe prova të reja ose kur gjykon se procedura e ndjekur nuk ka respektuar këtë rregullore. Në rastin e fundit merret masë për anëtarin e KDGJP të shkallës së parë, që nuk ka zbatuar rregulloren dhe largim nga detyra. KDGJP i shkallës së dytë zëvendëson për çështjen në fjalë anëtarin e larguar kur nuk ka mundësi brenda KDGJP të rajonit përkatës, me një anëtar të një KDGJP të një rajoni tjetër. Presidenti i UFSH, brenda 2 ditëve punë nga largimi, shpall datën e mbledhjes së Asamblesë Rajonale jo më parë se 30 dite pune për të zgjedhur anëtarin e ri të KDGJP të rajonit përkatës.

Vendimi i Komisionit Disiplinor të shkallës së dytë të gjykimit është përfundimtar. Ai u komunikohet palëve me shkrim brenda 5 ditëve pune nga vendimi, në adresat e komunikuar nga palët në fillim të gjykimit.

Për masën disiplinore "d", të parashikuar në pikën 1 të këtij neni personi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës brenda 20 ditëve pune nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.

Neni 18

Ekipe Ndihmëse në veprimet Disiplinore

Në rastet kur KDGJP i shkallës së parë e gjykon të nevojshme i kërkon Këshillit Rajonal të caktohet ekip ndihmës me këtë përbërje, (të plote ose të pjesëshme):

1. Një ose dy farmacistë me detyrën e verifikimit paraprak dhe të *Relatuesit*.
2. Ekspertë farmaceutikë me eksperiencë në vartësi të përmbajtjes dhe specifikës së çështjes së ngritur për gjykim.

Ekipe të ndihmese, për shkallën e parë të gjyqimit, caktohen nga kryesia e Këshillit Rajonal, ndërsa për shkallën e dytë nga Bordi Drejtues i Aparatit Qëndror Ekzekutiv të UFSH.

Neni 19 **Salla e Seancës Dëgjimore**

Sallat për zhvillimin e seancave dëgjimore zgjidhen të përshtatshme, për të siguruar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

1 - GJYKIMI NE SHKALLE TE PARE

A. FILLIMI I VEPRIMIT DISIPLINOR NE KESHILLIN RAJONAL

Neni 20 **Rradha e veprimeve paraprake në Këshillin Rajonal**

a. **Protokollimi i ankesës**

Ankesa apo kërkesa e mbërritur, protokollohet dhe regjistrohet në Regjistrin e posaçëm të ankesave.

b. **Ngritja e KDGJP të shkallës së Parë**

Presidenti i KR urdhëron ngritjen e Komisionit Disiplinor dhe caktimin e anëtarëve të tij për çështjen që do të gjykohej.

KDGJP i shkallës së parë :

c. **Përpilimi me shkrim i kërkesës me farmacistin**

Përpilon me shkrim kërkesën për takim me farmacistin, në adresë të të cilit është bërë ankesa.

d. **Marrja në pyetje e farmacistit**

KDGJP merr në pyetje farmacistin, ndaj të cilit është bërë ankimi, për fakte e të dhëna plotësuese si dhe e njeh atë me:

- ankesën e ardhur në adresë të tij, duke i dorëzuar një kopje të saj;
- procedurat, që kryen për gjykimin disiplinor profesional;

- detyrimin, që brenda 10 ditëve pune nga momenti i njoftimit të paraqesë mbrojtjen e tij me shkrim, si dhe dëshmi e dokumente kundërthënëse për ankesën e paraqitur;

Kur Farmacisti nuk pranon të përgjigjet kjo shënohet në procesverbal.

e. Thirrja në takim e palës ankuese

KDGJP thërret në takim palën ankuese për verifikim dhe informacion plotësues mbi, pretendimet, kërkesat, synimet e saj dhe gadishmërinë për t'u ballafaquar me palën tjetër. Pyetjet nëse ka ose jo dëshmitarë dhe materiale shtesë, që sqarojnë më tej çështjen në fjalë.

f. Kërkesa për farmacistët Verifikues-Relatues

KDGJP i kërkon eventualisht Këshillit Rajonal përcaktimin e një farmacisti Verifikues-Relatues dhe e njeh atë me detyrën, që do të kryejë.

Relatuesi pajiset, për të mos u penguar në punën e tij, me autorizimin përkatës, të nënshkruar nga Presidenti i Këshillit Rajonal.

g. Njoftimi me shkrim i Presidentit të UFSH-së

KDGJP brenda 10 ditë pune njofton me shkrim Presidentin e UFSH për ankesën e paraqitur dhe gjithë procedurën e ndjekur prej saj si dhe i kërkon bashkëpunim në procesin e plotësimit të informacionit dhe verifikimit paraprak.

Neni 21

Detyrat e relatuesit dhe radha e veprimeve

Relatuesi ka detyrë të sigurojë një informacion të saktë dhe të bëjë verifikimin paraprak të saktë dhe objektiv të çështjes për gjykim. Për të përmbushur detyrën e vet, relatuesi kryen sipas rradhes :

1.Takim me farmacistin e paditur, të cilin e njeh përsëri me ankesën ndaj tij dhe i kërkon të paraqesë me shkrim sqarimet dhe mbrojtjen e tij.

2.Takim me palën ankuese, ku i bëhet e ditur procedura disiplinore, si dhe merr të dhëna sqaruese ose të hollësishme rreth ankesës.

3. Bllokim me procesverbal, të dokumentave zyrtare, që lidhen drejtpërdrejt me çështjen në gjykim, dhe i shqyrton ato.

4. Pyetje të dëshmitarëve apo persona të tjerë, kolegë e personel farmaceutik, të vendit ku punon. Dëshmitë e marra dokumentohen me shkrim dhe firmosen nga relatuesi dhe personat e pyetur.

5. Në përfundim të fazës verifikuese harton "**Raportin për Verifikimin Paraprak të Çështjes** " _____ "

Verifikimi paraprak përfundon jo më vonë se 10 ditë punë nga mbërritja e ankesës apo kërkesës me shkrim në Këshillin Rajonal.

Neni 22

B. ZHVILLIMI I SEANCES DEGJIMORE TE SHKALLES SE PARE TE GJYKIMIT

Proçesi disiplinor i shkallës së parë të gjyimit organizohet dhe kryhet nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Presidentit dhe të kryesisë së Këshillit Rajonal, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen deri në përfundim të tij.

Anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe ekipi ndihmës lajmërohen paraprakisht për datën, orën e mbledhjes dhe çështjen që do të gjykohet, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune, para datës së caktuar për seancën dëgjimore. Gjatë këtyre ditëve në zyrën e Këshillit Rajonal ata njihen me materialet e dosjes në tërësi

Nëse, nga anëtarët e Komisionit, gjatë studimit të Dosjes, kërkohen të dhëna të tjera, përveç atyre që përmbahen në Dosje, kryetari i Komisionit i kërkon KR, që përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, të caktojë ekipin ndihmës, sipas **nenit 18** të kësaj rregulloreje.

Seanca zhvillohet në 3 (tre) faza :

- a. Faza e hapur;
- b. Faza e mbyllur dhe vendimmarrja ;
- c. Shqiptimi i vendimit.

Seanca dëgjimore pasqyrohet në Procesverbal, të cilin e mban Sekretari i Komisionit Disiplinor.

Procesverbali përmban tregimin e vendit, të vitit, të muajit, të ditës dhe, kur është e nevojshme, edhe të orës, në të cilat ka filluar dhe është

përfunduar seanca, gjeneralitetet e personave që kanë marrë pjesë, tregimin e shkaqeve, mungesën e personave, që duhet të marrin pjesë dhe kërkesat e paraqitura nga palët.

Proçesverbali, pasi lexohet, nënshkruhet në çdo faqe nga Sekretari dhe Kryetari i Komisionit dhe ruhet në Dosjen e Çështjes.

Kur gjykohet e arsyeshme, ftohen të marrin pjesë në seancë degjimore drejtues specialistë të institucioneve shëndetësore, të interesuara drejtpërsëdrejti për çështjen në gjykim, anëtare të UFSH-së, të Këshillit Kombëtar etj.

a. Faza e hapur e seancës degjimore

1. Kryetari hap zyrtarisht seancën degjimore. Paralajmëron palët dhe të pranishmit të respektojnë rregullat për zhvillimin normal të seancës. Në të kundert seanca ndërpritet dhe shkaktarit i bëhen ngarkim shpenzimet e saj. Pastaj, Kryetari vazhdon duke komunikuar shprehimisht se:

" Ankuesi/kërkuesi _____ ka ankimuar në Këshillin Rajonal të UFSH-së farmacistin _____ për _____

Në bazë e në zbatim të Ligjit 9150 dt. 30.10.2003 "Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë", të Kodit Deontologjik Farmaceutik, të Statutit të UFSH-së, të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional si dhe legjislacionit farmaceutik në fuqi, deklaroj të hapur seancën degjimore për Gjykim Profesional të çështjes së sipërpërmendur.

1. Sekretari i komisionit paraqet të dhënat e dosjes, duke lexuar titullin e secilit dokument dhe duke ia bërë të dukshëm atë Komisionit dhe palëve.
2. I jepet fjala Relatuesit (nëse ka), i cili lexon Raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes.
3. Kryetari i Komisionit u drejton pyetje palëve.
4. Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit nëse kanë pyetje për palët në gjykim, si dhe për ekspertët në përbërje të ekipit ndihmës.

5. Para mbylljes së seancës, u jepet fjala palëve në gjykim, në fillim asaj të paditur, pastaj palës tjetër, nëse kanë kërkesa për sqarime dhe shpjegime të tjera.

6. Komisioni tërhiqet për të marrë Vendimin.

Nëse gjatë seancës lind kërkesa për verifikime plotësuese, Komisioni vendos nderprerjen e seancës duke e pasqyruar këtë në Proçesverbal, i cili firmoset nga Kryetari dhe Sekretari i Komisionit. Seanca tjetër zhvillohet jo më vonë se 10 dite pune nga ndërprerja e kësaj seance. Nëse për arsye të argumentuara dhe raste të veçanta kryetari i KDGJP të shkallës së parë gjykon të pamjaftueshme kohën në dispozicion për verifikimet e parashikuara, i kërkon KR ose presidentit të KR zgjatjen e afatit të verifikimeve.

b. Veprimet në fazën e mbyllur dhe vendimmarrja

* Seanca vazhdon pa praninë e personave të tjerë, përveç anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Në këtë seancë:

- 1- Kryetari u kërkon anëtarëve të Komisionit Disiplinor të diskutojnë dhe të shprehin mendimin e tyre për masën ndëshkuese, duke e argumentuar atë.
- 2- Duke marrë në konsideratë mendimet e parafolësve, Kryetari propozon masën ndëshkimore, që e konsideron më të përshtatshme mbështetur në fakte dhe prova.
- 3- Propozimi i Kryetarit hidhet në votim të hapur kundrejt propozimeve të tjera alternative. Mbetet në fuqi masa ndëshkimore që ka shumicën e thjeshtë të votave.
- 4- Plotësohet Fleta e Vendimit (*sipas këtij formati*) dhe futet në dosjen e çështjes, si vijon;

"Sot më dt. _____ në Gjykimin Disiplinor Profesional të shkallës së parë të kryer pranë Këshillit Rajonal të _____, u bë votimi përsa i takon Z. _____ anëtar i UFSH-së, sipas ankesës së Z. _____. Votimi (përballë propozimeve) për masë ndëshkimore rezultoi : ____ me ____ duke u akorduar masa : _____"

KRYETARI (_____) **SEKRETARI** (_____)
ANETAR
(_____)

c. Shqiptimi i vendimit të shkallës së parë

Pasi i fton të pranishmit të vendosin qetësinë dhe të ngrihen në këmbë, Kryetari i Komisionit shqipton Vendimin duke u shprehur se :

“Komisioni Disiplinor pranë Këshillit Rajonal të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, _____ i mbledhur sot më dt _____ në Seancë Dëgjimore shqyrtoi ankesën e Z. _____ kundrejt anëtarit të UFSH-së Z. _____ për _____

Pas përfundimit të gjykimit të çështjes së sipërthënë, Komisioni Disiplinor, në bazë e për zbatim të LIGJIT Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, të Kodit Deontologjik Farmaceutik, të Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, Rregullores për Komisionet Disiplinore, akteve të tjera normative të UFSH si dhe të legjislacionit në fuqi,

V E N D O S I :

të deklarojë Z. _____ (jopërgjegjës) (ose) _____ (përgjegjës) për shkelje të

_____ . Për këtë Komisioni Disiplinor pranë këtij Këshilli i akordon Z. _____ masen ndëshkimore

—
Të ndëshkuarit i ngarkohën shpenzimet e të gjithë procedurës disiplinore për çështjen, sipas situacionit përfundimtar të Këshillit Rajonal të UFSH -së.

Palëve u komunikohet se kundrejt këtij Vendimi Disiplinor brenda 20 ditësh pune mund të bëhet ankim në Komisionin Disiplinor Kombëtar të shkallës së dytë {Apelit}. ”

- Sekretari i Komisionit zbardh Vendimin. Vendimi përpilohet në 4(katër) kopje origjinale të nënshkruara nga anëtarët e Komisionit , të vulosura si dhe të protokolluara . Nga një kopje origjinale u dorëzohet palëve në proces gjykimi, një kopje mbahet në Këshillin Rajonal dhe një kopje dërgohet në Aparatin Qëndror Ekzekutiv të Këshillit Kombëtar të UFSH-së.

2 - GJYKIMI NE SHKALLEN E DYTE (APELI)

Proçesi disiplinor i shkallës së dytë të gjykimit kryhet nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Presidentit të UFSH dhe të Bordit Drejtues të Aparatit Qëndror Ekzekutiv, të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen deri në përfundim të tij.

Verifikimi paraprak, nëse kërkohen të dhëna shtesë, si dhe gjykimi në seancë degjimore të Komisionit Disiplinor të Apelit, kryhen jo më vonë se 20 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës për rekurs.

Vendimi i gjykimit të shkallës së dytë (Apelit) është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Për masat disiplinore të parashikuara në gërmat « c » dhe « d » të pikës 1 të Nenit 16 të kësaj rregulloreje, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës, jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e marrjes së njoftimit të vendimit të Komisionit Disiplinor të Apelit

Neni 23

VEPRIMET PARAPRAKE PER GJYKIMIN NE APEL

1. Për çështjen e mbërritur në Apel njoftohet brenda 2 ditësh pune Presidenti i UFSH dhe Kryetari i Komisionit Disiplinor të shkallës së parë. Njoftohen njëkohësisht edhe palët, të cilave u jepet kopje e kërkesës për apelim dhe u kërkohet të sjellin brenda 7 ditëve pune kundër argumentat e veta.
2. Tërhiqet Dosja e Gjykimit të shkallës së parë, e cila dorëzohet me procesverbal në Zyrën Qëndrore të UFSH. Një fotokopje e saj mbahet në Këshillin Rajonal.
3. Kryhen procedurat për caktimin e Komisionit Disiplinor. Nëse komisioni gjykon se nevojitet *Ekip Ndihmës*, si *Ekip Ndihmës* mund të shërbejë ai i shkallës së parë, nëse pranohet nga ky Komision. Në të kundërt Bordi Drejtues i Aparatit Qendror Ekzekutiv të Urdhrit zgjedh një ekip ndihmës të ri.

4. Presidenti i UFSH njofton Kryetarin e KD të Apelit, i cili cakton ditën dhe orën e zhvillimit të seancës si dhe merr masa për të njoftuar me shkrim pjesëmarrësit, jo me pak se 7 (shtatë) ditë pune përpara zhvillimit të saj.

6. Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e Komisionit Disiplinor, njihen me dosjen në zyrat qendrore të UFSH.

7. Relatuesi ndërmerr veprime verifikuese plotësuese për probleme, që kërkohen nga Komisioni apo Ekspertët.

8. Bordi Drejtues i Aparatit Ekzekutiv merr masat për sallën si dhe për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e seancës.

Neni 24

MBLEDHJA E KOMISIONIT DISIPLINOR TE APELIT PËR SEANCËN DËGJIMORE

Përveç palëve në gjykim në seancë dëgjimore mund të marrin pjesë, Presidenti i Këshillit Rajonal dhe Kryetari i Komisionit Disiplinor të shkallës së parë që ka ndjekur çështjen që është për gjykim në Apel.

Seanca degjimore e Apelit pasqyrohet në Proçesverbal duke respektuar dhe zbatuar të njëjtat rregulla si në shkallën e parë të gjykimit (Neni 22) dhe zhvillohet në 3 (tre) faza :

- A. Seanca dëgjimore e hapur .
- B. Seanca dëgjimore e mbyllur (vendimmarrja) .
- C. Shqiptimi i vendimit.

A. Seanca dëgjimore e hapur

Zhvillimi i seancës :

1. Kryetari i Komisionit Disiplinor deklaron hapjen e seancës dëgjimore të çështjes « _____ » të paraqitur nga pala ankuese Z/Znj. _____, ndaj Vendimit Nr. __, datë. _____ të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë _____, për masën ndëshkimore _____ të akorduar ndaj farmacistit _____.
2. I jepet fjala Relatuesit, i cili lexon pretendimet e palës ankuese ndaj vendimit Nr. __, datë _____, të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë pranë Këshillit Rajonal _____, për masën ndëshkimore _____.
3. U jepet fjala palëve.
4. U jepet me radhë fjala anëtareve të Komisionit për të kërkuar sqarime rreth çështjes dhe pretendimeve të palëve në gjykim.
5. U jepet fjala ekspertëve dhe specialistëve të ekipit ndihmës, nëse ka.

6. Nëse, gjatë zhvillimit të seancës, kërkohen verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës dhe e pasqyron këtë në procesverbal të nënshkruar nga Komisioni Disiplinor i Gjyimit Profesional. Për këtë veprim njoftohet Presidenti i UFSH, i cili urdhëron kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Seanca pasardhëse bëhet jo me vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga ndërprerja e kësaj seance. Nëse, për arsye të argumentuara dhe raste të veçanta Kryetari i KD të apelit gjykon të pamjaftueshme kohën në dispozicion për verifikimet e parashikuara, i kërkon KK ose presidentit të UFSH zgjatjen e afatit të verifikimeve.
7. Kryetari e deklaron të mbyllur seancën, për të kaluar në procesin e vendimmarrjes në seancë të mbyllur.

B. Seanca e mbyllur (vendimmarrja)

Seanca vazhdon pa praninë e personave të tjerë, përveç anëtarëve të

Komisionit Disiplinor.

1. Kryetari hap diskutimet.
2. U jepet fjala me radhë anëtarëve të Komisionit, të cilët shfaqin mendimet dhe propozimet e tyre të argumentuara për masën ndëshkimore.
3. Kryetari, duke marrë në konsideratë mendimet dhe argumentat e parafolesëve, bën komentet dhe propozimin e vet për masën ndëshkimore.
4. Propozimi i Kryetarit hidhet në votim të hapur përkundrejt propozimeve të tjera alternative. Mbetet në fuqi masa ndëshkimore që ka marrë shumicën e thjeshtë të votave.
5. Plotësohet procesverbali i votimit sipas formatit standart.
6. Kryetari i Komisionit plotëson vendimin në rubrikat e formatit standart(shtojca 2 e kesaj rregulloreje).

C. Shqiptimi i vendimit në Apel

Bëhet në seancë dëgjimore të hapur:

Kryetari pasi fton të pranishmit të ngrihen në këmbë, lexon tekstin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe njofton palët për datën kur do t'u jepet kopja e vendimit.

Vendimi përpilohet në 4(katër) kopje, të cilat nënshkruhen nga anëtarët e Komisionit si dhe vulosen.

Një kopje e këtij Vendimi mbahet në zyrat qendrore të UFSH, një kopje dërgohet në Këshillin Rajonal dhe dy kopjet e tjera u jepen palëve.

PROÇESVERBAL VOTIMI I KD TE APELIT PRANE KESHILLIT KOMBETAR

“Sot më dt _____ në përfundim të gjykimit të shkallës së dytë të çështjes disiplinore ” _____ ” e ankimuar nga z. _____ përkundër Vendimit Nr. _____ dt. _____ të KD pranë Këshillit Rajonal _____ të UFSH të Shqipërisë, me votim të hapur u vendos që Z. _____ i shpallur me Vendimin e sipërthënë të shkallës së parë **përgjegjës/jopërgjegjës** për

t'i jepet/mos t'i jepet **Përfundimisht Masa Ndëshkimore Disiplinore :**

ANETARET E KOMISIONIT DISIPLINOR TE APELIT

ANETAR

/ _____ /

ANETAR

/ _____ /

ANETAR

/ _____ /

ANETAR

/ _____ /

**KRYETARI I KD TE APELIT
APELIT**

/ _____ /

SEKRETARI I KD TE

/ _____ /

**PJESA E TRETE
NORMA TE FUNDIT**

Neni 25

NJOFTIM INSTITUCIONEVE PER VENDIMET E GJYKIMIT DISIPLINOR

Vendimi Disiplinor i bëhet i ditur institucioneve të përfshirë në çështjen e gjykuar.

Në raste të veçanta, Vendimi i Komisionit u njoftohet Ministrit të Shëndetësisë, ISKSH, Departamentit të Farmacisë, QKL, Këshillave

Rajonalë të UFSH-se dhe institucioneve që kanë të bëjnë me Vendimin në fjalë.

Neni 26

DETYRIMI PER KALLEZIM NE ORGANET E DREJTESISE

Kur, gjatë fazës së verifikimit paraprak të çështjeve ose gjatë seancave dëgjimore, janë vënë re elementë, që i kalojnë kompetencat e gjykimit profesional të Urdhrit të Farmacistëve, Presidenti i Këshillit Rajonal detyrohet të njoftojë presidentin e UFSH, i cili në rrugë institucionale njofton Organet e Drejtësisë.

Neni 27

MUNGESAT NE SEANCE DEGJIMORE

Seanca dëgjimore shtyhet kur njëra nga palët, që janë në dijeni se çështja e tyre merret në shqyrtim në seancë dëgjimore, ose anëtarët e KDGJP janë më pak se tre në KDGJP të shkallës së parë dhe më pak se shtatë në KDGJP të shkallës së dytë, ose kur ekipi ndihmës mungon për arsye të përligjura nëse ka njoftuar paraprakisht mosardhjen dhe arsyen e saj. Seanca dëgjimore e radhës do të zhvillohet jo më vonë se 10 ditë pune.

Nëse njëra nga palët nuk paraqitet pa arsye të përligjura dhe pa lajmeruar paraprakisht, çështja shqyrtohet në mungesë.

Vlerësimin e rrethanave të mësipërme ka ta drejtë ta bëjë Kryesia e Këshillit përkatës me kryetarin e KDGJP të shkallës së parë dhe Presidenti i UFSH me Kryetarin e KDGJP të shkallës së dytë, duke hartuar një procesverbal, që vendoset në dosje i numërtuar.

Për rastet kur është e vërtetuar se mosparaqitja në Komisionin Disiplinor është e qëllimshme, kjo përbën një rrethanë rënduese, e cila merret domosdoshmërisht në konsideratë nga Komisioni Disiplinor në shqyrtimin e çështjes së dhënë.

Neni 28

PJESËMARRJA NË SEANCË DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE MEDIAN

Për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të publikut në seancën dëgjimore si dhe për komunikimin me mediat, vendoset për çdo rast në mënyrë të vecantë. Vendimin e merr Presidenti i UFSH, pavarësisht shkallës së gjykimit.

Neni 29

SHPERBLIMI I PJESEMARRJES NE PROÇESET DISIPLINORE

Të gjithë anëtarëve të Komisioneve Disiplinore dhe ekspertëve të përfshirë në verifikime dhe procese disiplinore, UFSH-ja i rimbursion të

gjitha shpenzimet operative, sipas mënyrës dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar.

Kur dërgohen me shërbime jashtë rrethit, ata përfitojnë shpenzime udhëtimi e dieta, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave në fuqi.

Çdo anëtar i KD1 e KD2 pjesëmarrës në çështjet në gjykim, i jepën honorare sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar.

Neni 30

SHPENZIMET E UFSH-se PER PROÇESET DISIPLINORE

Shpenzimet e strukturave të UFSH-së në funksion të proceseve disiplinore përbëhen nga:

- Shpenzime udhëtimi e dieta;
- Shpenzime operative

Në përfundim të gjykimit të çështjes, me Vendimin Disiplinor të formës së prerë, hartohet Situacioni Përfundimtar i Shpenzimeve Disiplinore, ku do përfshihen të gjitha shpenzimet që janë dhënë fillimisht nga UFSH-ja.

Neni 31

SHPENZIMET PER PROÇESET DISIPLINORE

Detyrimi financiar dhe të gjitha shpenzimet operative, të dokumentuara sipas situacionit përfundimtar, përballohen nga Urdhri.

Për zbatimin e Vendimit të formës së prerë ngarkohet Kryesia e Këshillit Rajonal për shkallën e parë të gjykimit dhe Zyra Qëndrore e UFSH-së për shkallën e dytë të gjykimit.

Neni 32

HYRJA NE FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**Rishikuar me VKK nr.22, datë 09/07/2010, ndryshuar me VKK
nr. 21.datë 08.06.2012**